

INFORMATA MBI GRANTIN

Emri i grantit:	FILMITRO II: NARRATIVA URBANE
Instrumenti:	Grant i vogël për projekt
Subjekti zbatues:	Public Space Equity - PSE
Kontaktet (adresa, emaili, telefoni, website):	Rr. "Skënderbeu" 17, Mitrovicë publicspaceequity@gmail.com +383 49 188 509 https://www.linkedin.com/company/public-space-equity/
Kohëzgjatja e grantit:	Data e fillimit: 01/07/2026 Data e përfundimit: 31/01/2027
Buxheti total i grantit (EUR):	9980.00 EUR
Buxheti i mbështetur nga programi EJA Kosovë (EUR):	9980.00 EUR
Grupet e synuara:	• Gratë • Të rinjtë • Personat me aftësi të kufizuara • Të moshuarit • Minoritetet etnike
Shtrirja gjeografike:	6 zona të ndryshme urbane & periferike të Mitrovicës së Jugut
Përmbledhje e grantit:	Projekti "FILMITRO II: Narrativa Urbane" synon të kontribojë në ngritjen e vetëdijes mbi ekuitetin në hapësirat publike përmes përdorimit të filmit dokumentar si mjet qytetar për dokumentim, reflektim dhe dialog publik. Duke u bazuar në rezultatet dhe metodologjinë e provuar të projektit FILMITRO 1, projekti fuqizon grupet e marginalizuara, përfshirë gratë, të rinjtë, personat me aftësi të kufizuara, të moshuarit dhe minoritetet, si dhe profesionistët e rinjë/studentët për të artikuluar përvojat e tyre në raport me përdorimin dhe qasjen në hapësirat publike dhe rreth objekteve publike. Përmes prodhimit të 6 filmave dokumentarë të shkurtër, projekti gjeneron gjetje konkrete për rreth 6 zona urbane dhe/apo periferike, duke i shndërruar ato në mjete reflektimi dhe avokimi publik. Projekti zbatohet gjatë një periudhe 7-mujore në qytetin e Mitrovicës si pikë studimi, ndërsa planifikohet që filmat e krijuar aty të shfaqen në 3–5 qytete të tjera të Kosovës përmes një cikli kombëtar shfaqjesh dhe diskutimesh. Aktivitetet kryesore

Bashkëfinancuar nga:



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Swiss Agency for Development
and Cooperation SDC



Suedia
Sverige

	përfshijnë fazën e përgatitjes dhe hulumtimit pjesëmarrës mbi komunitetet e targetuara në 6 lokacionet e piketuara, një punëtori të zgjeruar 7-ditore të filmit për 15–20 të rinj/studentë, prodhimin e 6 filmave tematik, shfaqje publike dhe diskutime me komunitetin dhe institucionet lokale, si dhe realizimin e një ndërhyrjeje taktike urbane në Mitrovicë, të bazuar në gjetjet ndërgjegjësuere të filmave. Projekti përfshin në mënyrë aktive qytetarët dhe grupet e synuara në të gjitha fazat e zbatimit. Ky projekt synon të vendos bazën konceptuale dhe strukturore për zhvillimin e FILMITRO-s si platformë e qëndrueshme dhe festival tematik, si objektivë strategjike afatmesme e organizatës PSE, që lidh filmin, hapësirat publike dhe ndërhyrjet taktike urbane, me fushë veprimi në Mitrovicë dhe më vonë në qytete të tjera të Kosovës.
--	---